



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Prokurori i Shtetit/ Državni Tužilac/ State Prosecutor

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit/ Kancelarija Glavnog Državnog Tužioca / Office of the Chief State Prosecutor

A.nr. 163/2021

Datë: 27/05/2021

Prishtinë;

Kryeprokurori i Shtetit, në pajtim me nenin 1 paragrafi 1 dhe pika 1.1, 1.3, 1.5 dhe 1.6 të Ligjit nr.05/L-034 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-225 për Prokurorin e Shtetit me qëllim të mos dërgimit në ndërmjetësimin rastet e dhunës në familje dhe me qëllim të zbatimit unik të praktikave pas ndryshimeve në legjislacion - Kodin Penal dhe Ligjin për Ndërmjetësim, si dhe bazuar në procedurat standarde të veprimit për ngritjen e efikasitetit në trajtimin e rasteve të dhunës në familje nxjerr këtë:

UDHËZIM

Për mos dërgim në ndërmjetësim të rasteve të dhunës në familje

Rastet e dhunës në familje, Prokurorët e Shtetit, në asnjë rast mos t'i dërgojnë në ndërmjetësim si procedurë alternative për zgjedhjen e rasteve.

Rastet e dhunës në familje përfshijnë, si veprën penale, Shkelja e urdhrit mbrojtës, nga neni 25 i Ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje dhe veprat penale nga neni 248 i Kodit Penal, si dhe veprat tjera penale të cilat kryhen apo tentohen të kryhen kundër personit me të cilin kryerësi ka qenë apo është në marrëdhënie familjare, përkatësisht rastet kur kemi të bëjmë me viktimë të ndjeshme e ku është i përfshirë si i dëmtuar partneri familjar sipas nenit 113, pika 39 i Kodit Penal.

Bazuar në Ligjin për Ndërmjetësim Nr. 06/L-009, procedurat e ndërmjetësimit nuk zbatohet për rastet që kanë të bëjnë me dhunën në familje, në pajtim me Ligjin kundër Dhunës në Familje ose për çdo mosmarrëveshje për të cilat është paraparë përgjegjësia ekskluzive e gjykatës apo ndonjë organi tjetër kompetent.

Arsyetimi

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, ka vërejtur se prokurorët që merren me rastet e dhunës në familje, qoftë kur i trajtojnë rastet e shkeljeve të urdhrave mbrojtës, qoftë kur i trajtojnë rastet tjera me element të dhunës në mes partnerëve familjar, shpeshherë kallëzimet penale i dërgojnë në ndërmjetim tek ndërmjetësi i certifikuar.

Praktika e referimit të kallëzimeve penale tek ndërmjetësit, për rastet e dhunës në familje nuk është në pajtim as me ligjin vendor (Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës), Ligjin për ndërmjetësim Nr. 06/L-009, dhe as me instrumentet ndërkombëtarë që mbulojnë këtë fushë.

Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës në nenin 232 ka paraparë që kallëzimet penale për një vepër penale të dënueshme me gjobë ose me burgim deri në 3 vjet mund të dërgohet në ndërmjetësim. Por, Ligji për ndërmjetësimin neni 2, paragrafi 2. ka paraparë shprehimisht që *“Ndërmjetësimi në fushën penale zbatohet në rastet ku parashihet dënimi me gjobë dhe dënimi me burgim deri në tri (3) vjet, përveç rasteve të parapara në paragrafin 3. të këtij neni”, ku thuhet shprehimisht: Ndërmjetësimi dhe procedura e ndërmjetësimit nuk zbatohet për rastet që kanë të bëjnë me dhunën në familje, në pajtim me Ligjin kundër Dhunës në Familje ose për çdo mosmarrëveshje për të cilat është paraparë përgjegjësia ekskluzive e gjykatës apo ndonjë organi tjetër kompetent”.*

Andaj, kjo dispozitë i jep mundësinë prokurorëve që për të gjitha veprat penale edhe ku parashihet dënimi kumulativ me gjobë dhe burgim deri në 3 vjet të dërgohen në ndërmjetësim, përveç rasteve të dhunës në familje, për faktin se natyra e veprës penale të dhunës në familje është e tillë që nuk lejon shprehje të lirë të vullnetit nga ana e të dëmtuari, çka viktimën dhe kryerësin i bënë palë të pabarabartë në procedurë.

Natyrisht, prokurori para se ta dërgoj rastin në ndërmjetësim duhet të merr parasysh llojin dhe natyrën e veprës, rrethanat në të cilën është kryer, personalitetin e kryerësit, dhe dënimet e mëparshme të tij për të njëjtën vepër penale apo për veprat penale të ndryshme si dhe nivelin e përgjegjësisë penale të tij.

Për më tepër ligji për ndërmjetësim, neni 12. paragrafi. 2, thotë:

“Palët në procedurë janë të lira të vendosin për zhvillimin e procedurës së ndërmjetësimit”,

Ndërsa me tutje:

Neni 11. paragrafi 2. *“Procedura e ndërmjetësimit për të gjitha rastet e parapara në dispozitat e këtij ligji fillon në momentin kur palët nënshkruajnë marrëveshjen për ndërmjetësim me shkrim për fillimin e procedurës së ndërmjetësimit”.*

Po ashtu, neni 14. paragrafi 1. *“Marrëveshja për zgjedhjen e ndërmjetësuar varet ekskluzivisht nga vullneti i palëve”.*

Andaj, pas krahasimit të të gjitha këtyre dispozitave vijmë në përfundim se njëra palë që ka ushtruar dhunë dhe pushtet dominimi, ndërsa tjetra viktimë e dhunës dhe e nënshtruar këtij dominimi nuk mund të lidhin marrëveshje bazuar në vullnetin e dyanshëm.

Përveç ligjit vendor, tërthorazi ndërmjetësimin në rastet e dhunës në familje e ndalon edhe Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje e quajtur si “Konventa e Stambollit” e cila është bërë pjesë integrale e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Në nenin 48 të Konventës, ndalimi i proceseve të detyrueshme alternative të zgjidhjes së konflikteve ose dënimit, në nenin 1 theksohet:

“Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të ndaluar e detyrueshme alternative të zgjidhjes së konflikteve duke përfshirë ndërmjetësimin dhe pajtimin në lidhje me të gjitha format e dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj konvente”.

Në vlerësimin e bërë të kësaj fushe, në mes tjerash është rekomanduar se duke qenë se dhuna në familje është model ciklik i sjelljes, siguria e viktimës dhe bashkimi i familjes janë qëllime të papërputhshme kur marrëdhënia përfshinë dhunë në familje.

Nisur nga këto arsye, konsideroj se zbatimi i këtij udhëzimi do të bëjë që çështja e dhunës në familje të adresohet me më shumë seriozitet dhe përgjegjësi. Ndërsa, viktimave do t'u mundësohet trajtim i duhur dhe i barabartë në të gjitha rastet dhe në tërë territorin e vendit.

Ky udhëzim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij nga Kryeprokurori i Shtetit.

Ky udhëzim e shfuqizon udhëzimin e mëparshëm A.nr.360/16, të datës 29 qershor 2016.

Mos respektimi i këtij udhëzimi mund të konsiderohet si shkelje të Kodit të Etikës për prokurorë.

Kryeprokurori i Shtetit

Aleksandër Lumezi



Udhëzimi i dërgohet;

- Kryeprokurorëve të prokurorive themelore dhe të gjithë prokurorëve të shtetit;
- Kryeprokurorit të Prokurorisë së Apelit dhe Prokurorisë Speciale;
- Arkivit të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit (ZKPSH).

Obligohet administrata e ZKPSH-së që këtë udhëzim ta publikoj në ueb faqen e Prokurorit të Shtetit.